



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 29.4.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha.

Munguan : Haxhi Shala, Lahi Brahimaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 21.4.2015,
3. Shqyrtimi i gjendjes së mjedisit në rajonin e Drenasit për shkak të ndotjes së mjedisit nga Feronikli, me Ministrin e Mjedisit,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.4.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar. **Shaip Muja** potencoi që rekomandimet e mbledhjes së kaluar me ato të sotme dallojnë vetëm kozmetikisht ngase komisioni është marr vesh që të bëhet fjalë për cilësinë e grurit të importuar e jo për cilësinë e miellit.

3. Shqyrtimi i propozim rekomandimeve të grupit punues rreth çështjes së cilësisë së grurit te importuar

Kryetari përshëndeti anëtarët e komisionit dhe i ftoi për vërejtjet eventuale për rekomandime përfundimtare rreth çështjes së grurit, mirëpo pas leximit të tyre dhe vërejtjeve nga ana e **Adem Salihajt**, bëri ndërhyrjen e tij **Shaip Muja** i cili konstatoi se këto rekomandime nuk tregojnë a kemi në Kosovë grurë me cilësi apo jo dhe a kemi respektim të ligjit apo kundërshtim. Ai gjithashtu vuri aksentin në dështimin e Qeverisë në mbikëqyrjen e cilësisë së grurit duke thënë “neve nuk na intereson cilësia e grurit” (përgjigja e ministrit të bujqësisë kur është ftuar në komision), ndaj shtoi se komisioni është dashur të alarmoi këtë duke ftuar edhe kryeministrin dhe të sqarohen gjërat në mënyrë institucionale, përndryshe sikurse me veprimet e ndërkombëtarëve në periudhën e mëhershme ashtu edhe tani si duket MB do të uzurpohet nga një institucion, tani vendor. Në vazhdim ai shpallti edhe disa vërejtje tjera rreth rekomandimeve të cilat u evidentuan nga stafi, duke potencuar se me ato kundërshtohen rregullat e Ceftës, në çka reaguesit hartuesit e rekomandimeve z. Salihu dhe Salihaj duke u përgjigjur se askush nuk ka shkruar se duhet të ndalohet importi i grurit nga shtetet e rajonit. Z. Muja gjithashtu potencoi një fakt, si tha ai me rëndësi, që Qeveria ka thënë se janë dërguar analizat në Itali, ndaj pyeti a duhet të presim në këto analiza apo të konstatojmë se ka parregullsi p.sh. si të përgjigjemi ne si deputet gazetarëve të cilët thonë: a kemi rezultate negative apo pozitive, pra duhet të jemi preciz dhe të vërtetojmë a ka përdor popullata miellin me cilësi apo jo, përfundoi ai lidhur me këtë konstatim. Sa i përket stimulimit të prodhimit vendor që kërkohet me rekomandime, ai tha se kjo është vetëm filozofi, asgjë tjetër. **Salih Salihu** arsyetoi rekomandimet duke potencuar se GP ka analizuar kundërshtimet e palëve të involvuara të cilat kanë treguar parregullsi të shumta, e që padyshim tregojnë se edhe rendimenti nuk është ashtu si duhet, në anën tjetër argumentet tregojnë se gruri i Kosovës është më cilësor në rajon, edhe se ai i Serbisë, mirëpo tregtarët që lejohen nga ky shtet, shesin miellin e lirë 25 euro 100 kg me çka krijohet situata anormale, askush nuk mbjellë miell në Kosovë sepse “nuk ka hesap”. Më tej ai vazhdoi duke konstatuar se rekomandimet kanë evidentua se nuk ka pasur mbikëqyrje nga Qeveria te doganat dhe shumë gjëra tjera. **Adem Salihaj** ndërhyri dhe shtoi se doganat thonë se dedikimi është për eksport por askush nuk mbron se shitet edhe brenda. **Murat Hoxha** ishte i balancuar dhe tha se ne duhet me pas edhe çmim të lirë edhe ushqim të lirë, ndaj rekomandimet e propozuara janë të buta apo të forta, varet për kënd dhe shtoi se Rekomandimet parashohin që mund të ndalet evazioni fiskal. Kryetari **Fikrim Damka** pasi që konstatoi se nuk janë pjek kushtet për vendosje rreth rekomandimeve, sugjeroi të shqyrtohen këto rekomandime edhe një herë javën tjetër.

4. Shqyrtimi i gjendjes së mjedisit në rajonin e Drenasit për shkak të ndotjes së mjedisit nga Feronikli, me Ministrin e Mjedisit

Pasi që prezantoi ministri **Ferid Agani** me bashkëpunëtorë, kryetari falënderoi dhe të njëjtin e ftoi për raportim rreth çështjes në fjalë dhe në përgjithësi për ndotjen mjedisore. Ministri në fillim fokusoi problemet me të cilat është ndeshur që në fillim të mandatit të tij dhe të cilave ju ka dhënë prioritet siç janë UA për gazra, çështjet buxhetore për monitorim të mjedisit, ndotjen e tokës, cilësia e ajrit dhe së fundi çështja e Drenasit përkatësisht kompanive ndotëse, për çka ja dha fjalën **Ilir Morinës**. Ai tha se një HOTSPOT (vendi ku ndikon një operator) i cili rrezikon shëndetin e popullatës, vazhdimisht raporton për gjendjen mjedisore, ndaj këto gjigante që ndotin mjedisin, pas gjobave të fundit dukshëm kanë përmirësuar gjendjen mjedisore duke investuar në pajisje dhe në përmirësim, gjithashtu edhe Feronikli kështu ka vepruar me sistemin vetmonitorues dhe është kompani me leje të integruar e cila sipas analizave nuk ka pasur tejkalime serioze dhe diçka shqetësuese. Kundërshtimet dhe padia konkrete me kallximin penal nga asambleisti z. Drenori për ne, vazhdoi, është e mirëseardhur ngase ajo tregon se gjërat po lëvizin. Mungesa e mjeteve buxhetore, vazhdoi, për mirëmbajtjen e aparaturës paraqet problem serioz për monitorimin e cilësisë së ajrit. Në Drenas ka munguar aparatura gjatë vitit të kaluar, ndaj nuk është bërë vlerësimi i cilësisë së ajrit, mirëpo ky vlerësim është bërë nga vet kompania

e cila për këtë qëllim ka kontraktuar laboratorin “TEHNO LAB LTD” i cili posedon licencë ndërkombëtare sipas së cilave analiza ka rezultuar se parametrat janë normale të cilësisë së ajrit. **Shaip Muja** falënderoi komisionin për mundësin e shprehjes së shqetësimit të tij dhe iniciativës rreth ndotjes së mjedisit në Drenas nga ana e kompanisë Feronikli. Ai kundërshtoi qasjen e ministrit dhe kryeshefit të agjencisë ngase përmirësimet që u cekën janë vetëm kozmetike ngase MMPH me një dorë ndihmon me tjetrën dëmton, njëherit ai citoi disa gjëra nga kallëzimi penal i dërguar në komision nga asambleisti komunal në Drenas, ku insistohet se gjatë vitit 2014 Drenasi nuk ka pasur monitorim të cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit etj ku ka pasur edhe ngordhje enigmatike të shtazëve. Ai shtoi se gjigantet tjera ndotëse kanë bërë përmirësime mirëpo kjo nuk ka ndodhë në Obiliq dhe Feronikël. Komisioni, vazhdoi ai, duhet të formoi një grup punues për hulumtimin dhe informimin më të detajuar të opinionit për këtë problematikë. **Murat Hoxha** tha se një thënjë thotë “as ideja me fantastike nuk lind se paku pa një bazë relae” dhe vazhdoi duke konstatuar se kjo që u dëgjua është një shqetësim dhe ne duhet me marr si alarm që duhet te merremi me kete. Është e vertete se peshkimi nuk zhvillohet ne lumin Drenica, flora dhe fauna e lumnejeve ne Kosove është e demtume e veqnaersiht ne lumin Drenica dhe shqetësimet per ndotje nga Feronikeli kane baze. Perfaqesuesi i Minsitrise, shtoi, nuk qe i bindshem qindperqind me ate qe tha dhe shihet se nuk jane marre masat e duhura ne Feronikel, por megjithatë la pershtypjen se është duke u punuar ne kete drejtim. Ai shprehu mendimin se kjo ministri është shumë e rëndësishme dhe nuk i jepet rëndësia nga Qeveria që duhet me i dhënë.

Ministri Ferid Agani plotësisht u pajtua me konstatimin e parafolësit dhe kjo do të jetë inkurajim për të që të kërkoi një bisedë me kryeministrin rreth iniciativave të cekura pikërisht për atë se mjedisi dhe energjia janë tepër të rëndësishme për një vend. Ai shtoi se pas njoftimit nga shkresat e komisionit, është befasuar dhe ka pyetur, si është e mundur mos me pas monitorim të ajrit nga agjencia në rajonin në fjalë. **Sekretari Arben Çitaku** dhe **Muhamet Malësiu** pohuan se monitorimi është obligativ dhe stacionet mbulojnë këtë rajon sipas dy lloj monitorimeve, vetmonitorimi dhe monitorimi i ajrit nga MMPH. **Shaip Muja** ndërhyri duke pyetur pse nuk flisni si qëndron gjendja deri në Grabovc dhe disa çështje tjera mjedisore , por **kryetari** megjithatë me kaq ndërpreu debatin rreth kësaj çështjeje duke premtuar se komisioni prapë do të fokusohet në këtë problematikë. Në vazhdim ai pyeti zyrtarët e MMPH rreth **projekteve kapitale** pse nuk barten në agjencinë e komplekseve memoriale, ndërkaq sekretari **Arben Çitaku** premtoi se ato projekte faza faza do të përcjellën në atë agjenci sipas vendimit të GP të formuar, një pjesë janë përcjellur, ndërsa pjesa tjetër nuk ka qenë e mundur pa u kry deri në fund, dhe kështu do të vazhdoi derisa të përfundojnë në tërësi gradualisht. Në fund ministri Agani kërkoi ndihmën nga ky komision për të dërguar një përfaqësues rreth çështjeve me pronësi të agjensionit të pronave dhe të pyjeve për tokat pyjore.

Mbledhja përfundoi në orën 15,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka